



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë për Zhvillim të Dokumenteve Strategjike
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	koeficienti 5.75
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	23/05/2023
Afati për aplikim	07/06/2023 - 14/06/2023
Institucioni	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Departamenti	Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
Divizioni	Divizioni për Koordinim të Politikave
Vendi i punës	kati 11
Nr. i Referencës	RN00011680
Kodi	RPC0005291



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Planifikim dhe zhvillimi i dokumenteve strategjike dhe ndihmon udhëheqësin e departamentit dhe divizionit në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
2. Ndihmon udhëheqësin e drejtpërdrejt në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
3. Ofron produkte dhe shërbimeve në fushën e zhvillimit të dokumenteve të planifikimit strategjik dhe hartimit të politikave dhe reformës së pushtetit lokal;
4. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me planifikimin, raportimin strategjik për qeverisjen lokale dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
5. Koordinon me departamentin ligjor dhe njësit tjera të institucionit rreth çështjeve ligjore të shfaqura gjatë procesit të zhvillimit të dokumenteve strategjike apo planifikuese;
6. Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në institucion;
7. Bënë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për vetëqeverisje lokale;
8. Koordinimi i hartimit të Planit të Punës së MAPL-së për Qeveri, dhe raporton për zbatimin e tyre;

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në juridik, ekonomik, administratë publike
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 21/06/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 10.07.2023 ora 14:00 kati 11 Ndërtesa e ish Rilindjes



8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

Aftësi dhe përvoja në planifikim dhe raportim;

Aftësi komunikimi, kontakte brenda dhe jashtë institucionit;

Iniciativë dhe kreativitet në punë;

Aftësi të menaxhojë çështjet komplekse, të ofrojë këshilla dhe udhëzime efektive;

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

